



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

seancën e pestë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më 2.6.2025 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Seanca do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për seancë propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancës së jashtëzakonshme dhe të seancës së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
3. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
4. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme MPB-së – Policisë së Kosovës;
6. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Këshillit Prokurorial të Kosovës;
7. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve;
8. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;

9. Propozim-vendimi për bartje të 45 normave nga cikli i mesëm i lartë në ciklin parafillor dhe fillor;
10. Propozim-vendim për ndërrim të destinimit nga banim individual në institucion arsimor privat;
11. Propozim-vendim për lënie në dëgjim publik të PRRH "Mati 1", blloku A 11;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-69228/25, më 19.5.2025

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

